

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali me sekretet shtetërore dhe marrëdhënia me Ergys Agasin, Vlora Hyseni kërkon heqjen e arrestit shtëpiak
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/skandali-me-sekretet-shteterore-dhe-marredhenia-me-ergys-agasin-vlora-i402249
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 12:38:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 12:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a90120462e3e33fc677801094d56776fc01c7d918f2348df6c696854a8353078
TEKSTI	b5aa2c9ee0da19cc074e26525faef91ed4a8b49d110096e499781e186e27fa9b
PAMJA	4275fed235b771267328e0d353cecd8789f6b130352d1c51d9a0cafca76653

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f8496a16a885dbf4c0acc24f282893c3f6556db286c351dfb4251ca2b2612b34
E MËPARSHMJA	d221cc362cba3913ae78881c2090daba72fdf470e4183e2a8d0e0c0e3ba7aaaf
RRËNJA MERKLE	4ccc1f1a7b0bcd85a4d154c0d42583811e3323ff976f0b5cd4a1ea64b7daae9e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f8496a16a885dbf4c0acc24f282893c3f6556db286c351dfb4251ca2b2612b34>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

29 Shtator 2026, 14:27

Skandali me sekretet shtetërore dhe marrëdhënia me Ergys Agasin, Vlora Hyseni kërkon heqjen e arrestit shtëpiak



Shkruar nga Newsbomb



Vlora Hyseni, GJKKO

Ish-shefja e SHISH-it, Vlora Hyseni e cila u arrestua dhe u la në arrest shtëpie pasi akuzohet për përkrahje të autorit të krimit dhe nxjerrjeve të sekreteve shtetërore, kërkon heqjen e masës së sigurisë.

Burime për mediat bëjnë me dije se Hyseni ka ankimuar çështjen e saj së fundmi në Apelin e GJKKO-së, duke kërkuar heqjen e masës "arrest shtëpiak".

Konkretisht, për Vlora Hysenin janë caktuar masat e sigurisë "Arrest në shtëpi" dhe "Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", si person nën hetim për veprat penale të parashikuara nga nenet 302/2 dhe 295/a/1 të Kodit Penal.

Nenet 302/2 dhe 295/a/1 të Kodit Penal bëjnë fjalë për Përkrahje të autorit të krimit, në këtë rast Ergys Agasi, në mënyrë që ai t'i shpëtojë kërkimit, kapjes ose arrestimit, si dhe Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete, dhënia e informacioneve të konsideruara sekret ndaj personave të tretë, sërish në këtë rast Ergys Agasi. Vlora Hyseni akuzohet për këto dy vepra penale dhe ndaj saj janë caktuar dy masat e sigurisë të mësipërme.

Pas shkarkimit nga detyra dhe vendosjes së saj nën masën "arrest në shtëpi", një tjetër detaj ka tërhequr vëmendjen rreth ish-drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni. Emri i saj është zhdukur nga faqja zyrtare e SHISH-it. Në historikun e

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

Sherri me Eduart Kuçin, Joz Marku reagon pas vendimit të Apelit: Nuk ndalem së ndriçuari



Showbiz & Lifestyle

Dhuno! Eduart Kuçin dhe e "reklamoi" në rrjet, Apeli nxjerr nga shtëpia Joz Markun (DETAJE)

Zbulu më shumë artikuj >

institucionit nuk shfaqet më as emri dhe as fotografia e ish-drejtoreshës, e cila deri pak ditë më parë qëndronte në krye të një prej strukturave më të rëndësishme të sigurisë kombëtare në Shqipëri.

Ndryshimi vjen pas skandalit që "shpërtheu" disa ditë më parë, ku SPAK kërkoi masën e sigurisë "arrest në shtëpi" për Hysenin, e cila akuzohet se ka nxjerrë sekrete hetimore dhe ka ndihmuar biznesmenin Ergys Agasi si para po ashtu dhe gjatë periudhës kur ishte shpallur në kërkim nga drejtësia shqiptare. Po ashtu, ajo u pezullua nga detyra ndërsa ndaj saj u ngritën dyshime për akuzat "përkrahje të autorit të krimit" dhe "zbulim të akteve ose të dhënave sekrete".

Në seancën e mbajtur në GJKKO, më 24 shtator, u la në fuqi masa e sigurisë "arrest në shtëpi" për Vlora Hysenin, mirëpo kjo e fundit kërkon heqjen e kësaj mase sigurie.

Skandali i ish-kreut të SHISH u thellua më tej, pasi në pjesë të dala nga dosja hetimore në ngarkesë të saj, u zbulua se Vlora Hyseni përveçse i jepte Ergys Agasi informacione nga sekretet shtetërore, ka pasur dhe një marrëdhënie të ngushtë me biznesmenin, të cilit i premtonte "fikjen e radarëve të shtetit" për të.

Në dosjen AKSHI deri tani kjo është historia më e fortë ku pasioni, pushteti, korrupsioni e krimi bëhen bashkë!

Këshilluar për ty



"Flej pa dert zemër, gjithë radarët i fik për ty!" Vlora Hyseni mesazhe dashurie ndërsa jep informacion për Ergys Agasin (MESAZHET E REJA)

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 14:51 Newsbomb

Motori përplas nxënësen në Cërrik, dyshohet se ishte me shpejtësi, e mitura plagoset rëndë



Aktualitet

Të shtënat me armë gjatë operacionit antidrogë në malet e Krujës, Policia sqaron: Efektivët qëlluan më ajër për të trembur kafshët e egra

E Martë 14:50

Aktualitet

Katastrofë ekologjike në Lushnjë, Bashkia than rezervuarin për të betonuar portat, por çon drejt ngordhjes mijëra tonë peshk (VIDEO)

E Martë 14:32



E Martë 14:06 Newsbomb

**“Revolucioni Flamingo” nuk e ndal dot!
Rama i prerë për Zvërnecin: Investimi do të bëhet, e vetmja që mund ta pengojë është.... (FJALA)**



Aktualitet

Nga punësimi pa kriter te pagesa e audituesve pa punuar, punonjësit e KLSH-së letër Begajt dhe Kuvendit: Mbikëqyrni institucionin! Ndryshe thuhet, ndryshe bëhet (DOKUMENTET)

E Martë 13:08 Newsbomb

Aktualitet

Gjendet një trup i pajetë pranë Urës së Farkës, dyshohet se e ka përplasur makina, detajet e para

E Martë 12:51 Newsbomb



E Martë 12:44

**Shpërthim i fuqishëm në një pikë
karburanti në Sarandë, dy persona të**

plagosur (EMRAT)



Aktualitet

Sherr me thika në Maliq, plagoset një person, shkak janë bërë bagëtitë (DETAJE)

E Martë 12:19



Aktualitet

Të shtëna me armë në Qafështamë, qëllohet drejt efektivëve të antidrogës

E Martë 11:50



E Martë 11:02 Newsbomb

Pas katër muajsh punë, Ilir Topi “liron” karrigen te Fondi i Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor, ministria Spahiu emëron sot pasuesen e tij (EMRI)



Aktualitet

Ministria Spahiu mbledh drejtuesit e QSUT, i POROSIT për pacientët: Më shumë eficiencë dhe përgjegjësi, fokusi të jetë te fëmijët

E Martë 10:22 Newsbomb



Aktualitet

Bashkë me vëllanë VRAU 36-vjeçar, tetë vite pas ngjarjes ARRESTOHET në Itali 28-vjeçari dibran, pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (EMRI-NGJARJA)

E Martë 10:06 Newsbomb



Aktualitet





🕒 E Martë 09:49

DETAJE nga shpërthimi që shoi gjashtë jetë në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi (HETIMET)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.